REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 859/20
Datë/Datum. 26.10.2020
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Një ankesë kundër: UNIVERSITETI I GJAKOVËS "FEHMI AGANI"
(Shëno emrin e Autoritetit Kontraktues)
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **97800-20-5047-5-1-1**

(Shëno numrin e Aktivitetit të Prokurimit)

Sa i përket tenderit për **Ndertimi i Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Gjakovës**

(Shëno titullin e kontratës si në Dosjen e Tenderit)

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

EUROBESI SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr Muharrem Fejza pn Prishtine
(Adresa)
Prishtine ***10000***
(Vendi) *(Kodi postar)*
049 878 500
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Sadik Krapi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
eurobesi@yahoo.com
(Adresa elektronike)

26-10-2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" apo "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Data e publikimit te njoftimit te kontrates 08.09.2020 ne E-prokurim
Data e dorezimit te ofertave: 28.09.2020 13:00
Data e njoftimit te vendimit te AK 14.10.2020 (Ne sistem nuk po mundemi me hap vendimin e AK dhe nuk kemi mund ta bashkangjesim si dokument gjate ankeses ne OSHP)
Data e dergimit te Letres Standarde te Eleminimit 15.10.2020 (permese emailes)
Kriteri i dhenies se tenderit : Oferta me cmimin me te ulet
Data e kerkeses per Rishqyrtim 16.10.2020
Data e pergjigjes nga AK ne Kerkesen per Rishqyrtim 22.10.2020 (permese emailes)

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po					**Jo**	X

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ? A keni bërë ndonjë reagim me shkrim dhe/ose kërkuar sqarime shtesë nga AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj, si dhe a u është përgjigjur me shkrim AK në lidhje me këtë? Nëse po, ofroni shkurtimisht detaje mbi këtë fakt:

Po	X				**Jo**	

Autoriteti Kontratkues ne e-prokurim ka publikuar vetem njoftim vendimin mirepo nuk ka publikuar Letrat Standarde sipas LPP-se dhe RRUOPP-se me arsyetimin qe nuk po e lejon sistemi me I publiku edhe pse ne rastet kur AK mund ta publikoje vendimin atehere pse atije vendimi nuk po I bashkangjiten edhe letrat standarde siq edhe e bejne shumica e AK -ve .

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 6 i LPP-se
Neni 7 i LPP-se
Neni 59 i LPP-se
Neni 60 i LPP-se

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me date 14.10.2020 ora16:22 ne e-prokurim AK ka publikuar dokumentin e Njoftim Vendimit per tenderin ne fjale mirepo ne ate vendim ka qene vetem lista e kompanive qe kane konkuruar ne kete tender si dhe OE I rekomanduar per dhenie te tenderit mirepo nuk kane qene te bashkangjitura letrat tstandarde per eleminimin dhe letrat standarde per tenderet e pasuksesshem.

Me date 15.10.2020 i jemi drejtuar me email z.Gani Veseli qe te na percjell Letren Standarde te eleminimit te kompanise sone dhe me email ne te njejten dite na ka derguar dokumentin me arsyeshmerine qe ne e-prokurim nuk po mundet te e ngarkoje.

Ne baze te Letres Standarde per Eleminim kompania jone eshte shpall e pa pergjegjshme per shkak se nuk ka dorezuar listen e punetoreve siq eshte kerkuar ne dosje te tenderit .

Me date 16.10.2020 kemi bere kerkese per rishqyrtim tek AK dhe me date 22.10.2020 kemi pranuar pergjigjen per refuzim te kerkeses tone per rishqyrtim.

Tek pergjigja per rishqyrtim AK perveq pikes per te cilen kemi pranuar Letren Standarde per Eleminim , AK ka shtuar edhe disa pika te tjera te cilat nuk kane qene pjese e rishqyrtimit tone pasi qe per ato pika ne nuk kemi pas vleresim te meparshem ne baze te Letres Standarde per Eleminim .

Tani kerkojme nga OSHP qe te vleresoje qe a duhet te jene pjese e vleresimit edhe pikat shtese te cekura nga ana e AK apo jo , mirepo ne edhe per keto pika shtese kemi arsyshmerine tone dhe jemi te pergjegjshem per te gjitha keto pika.

Sa I perket pozicioneve qe jane cekur ne pergjigjen per rishqyrtim nga ana e AK ju lutem gjeni arsyeshmerine tone si me poshte:

Pika 1 e pergjigjes nga ana e AK

I nderuar OE,ju jeni diskualifikuar-eliminuar me arsyetimin se nuk i keni përmbushur kërkesat e AK,te publikuara ne dosjen e tenderit te:Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pika 9.1&9.2 si me poshtë kërkesa nr.4

1. ***Kërkesa 4. Stafi i inxhinierve -Një (1) inxhinier i Arkitekturës -Një (1) inxhinier i Ndërtimtarisë, drejtimi konstrukt -Një (1) inxhinier i ndërtimtarisë, drejtimi hidroteknik -Një (1) inxhinier Elektrik -Një (1) inxhinier Mekanik***

1.Inxhinieri i arkitekturës Benjamin Halit Kabashi i cili ka regjistruar studimet e ciklit të dytë në një fakultet jasht Kosove me 10.10.2011, ka kryer studimet pesëvjeqare me 300 ECTS kredi dhe ka marrë diplomen më 15.12.2016 dhe ka të nostrifikuar për përdorim në Kosovë më 05.09.2018 gjë që dëshmohet se nuk ka 5 vite përvoj pune në lëmin e ndërtimtarisë bazuar në kriterin e DT ku kërkohen pesë vite përvoj pune pas diplomimit.

Arsyshmeria per kete pike:

Ne si staf profesional ne dosjen e tenderit kemi dorezuar 2 Inxhinier te Arkitektures ,ku njeri eshte emeruar si Menaxher I Projektit (Sinan Berisha) ndersa tjetri eshte si staf tjeter profesional (Benjamin Kabashi)
Sa I perket inxhinierit z.Benjamin Kabashi ne dosjen e tenderit kemi dorezuar diplomen e tije e cila deshmon qe data e diplomimit eshte 23.07.2012 dhe ploteson kriterin e pervojes 5 vjeqare , ndersa data e leshimit te diplomes 15.12.2016 eshte vetem date e leshimit te dokumentit por nuk percakton kohen e kryerjes se studimeve. Boterisht dihet qe data e diplomimit eshte data e mbrojtjes se temes ku edhe e merr titullin e caktuar, e ne kete rast titullin e inxhinierit te arkitektures. Pra AK gjate vleresimit ka bere gabim kur na ka shpall te pa pergjegjshem ne kete pike sepse z.Benjamin Kabashi ka diplomuar ne vitin 2012 dhe e ploteson kriterin e dosjes se tenderit.
Sa I perket nostrifikimit te diplomes me date 05.09.2018 kjo ska te beje fare me vleresimin e ketije tenderi sepse ne dosjen e tenderit nuk ka pas kerkese per nostrifikim te diplomave per staf mirepo ne e kemi bashkangjitur vetem si dokument shtese ne kete rast. Poashtu z.Benjamin Kabashi te gjithe pervojen e punes pas diplomimit e ka ne Kosove.

Andaj ne kete pike ne si kompani oferteuse jemi plotesisht te pergjegjshem.

Pika 2 e pergjigjes nga ana AK

Po ashtu ne kerkesen e njejte Inxhinieri i ndërtimtarisë Arbon Prekadini ka përfunduar studimet e tij master dhe fituar titullin Master i Shkencave Teknike të Ndërtimtarisë më 15.05.2017 që dëshmohet se nuk ka 5 vite përvoj pune në lëmin e ndërtimtarisë bazuar në kriterin e DT ku kërkohen pesë vite përvoj pune pas diplomimit.

Arsyshmeria per kete pike:

Sa I perket inxhinieri Arbon Prekadini ky inxhinier nuk eshte fare ne proceduren e vleresimit sepse kerkesat e dosjes se tenderit sa I perket Inxhinierit te Ndertimtarise I kemi permbushur me dy inxhinier tjere siq jane : Samil Pireci I emeruar si menaxher I punishtes dhe Besian Sinani I cili eshte pjese e stafit ne dosjen e tenderit e I cili permbush kerkesen e inxhinierit te ndërtimtarise .
Pra AK nuk ka bere vleresim real per kete tender sepse Arbon Prekadini nuk merret parasysh ne vleresim te dosjes se tenderit mirepo pasi qe eshte staf i kompanise ne kemi ngarkuar ne dosjen e tenderit edhe dokumentet e tije ne menyre qe te deshmojme qe kemi staf te mjaftueshem qe te menaxhojm kete kontrate.
Pra edhe ne kete pike jemi plotesisht te pergjegjshem .

Pika 3 e pergjigjes nga ana AK

Kerkesa nr5 si me poshte e kerkuar nga AK ne dosje te tenderit.

Dëshmia 5. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe pregatitje shkollore numri i punetorve 30 dhe te kete kontrata me punetor ose parakontrata. Puntorë të profileve të ndryshme.

Ne kemi gjetur keto te dhena ne listen e stafit te punetorev qe bien ne kundershtim me DT, dhe kerkesat e AK,

2. *Lista e stafit nuk është e plotësuar me 30 punëtorë sipas DT. Në listen prej 38 punëtorëve janë të përfshirë edhe punëtoret profesional (inxhinierët), administrative dhe juridik, si dhe punëtorët e ndërtimtarisë.*
   Bazuar në ARBK N.P. "Euro-Besi" është themeluar me 11.03.2004 si Biznes Individual e cila është shëndruar në SH.P.K. "Euro-Besi" me numër të ri biznesi 71211568 më 30.10.2015, ndërsa kemi gjetur se disa nga punëtorët të cilët janë të përfshirë në listen e stafit kanë kontrata pune të lidhura si psh:
   - *Përsoni me nr ID 1019566621 me datë 01.12.2014 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;*
   - *Përsoni me nr ID 1006445914 me date 01.01.2011 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;*

- *Përsoni me nr ID 1179074704 me datë 01.01.2011 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;*
- *Përsoni me nr ID 1002777661 (njëkohësisht me vendim për menaxher punishte) me datë 06.01.2014 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;*
- *Përsoni me nr ID 1012376720 me date 01.01.2014 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;*
- *Përsoni me nr ID 1170555321 me datë 20.03.2012 ka kontrat e cila është e vulosur me vulë "Euro-Besi" SHPK kur si e tillë është formuar me 30.10.2015;*
-

Arsyshmeria per kete pike:

Ne si kompani kemi dorezuar listen e 38 te punesuarve ne kompani te cileve ua kemi bashkangjitur kontratat dhe parakontratat me secilin nga te punesuarit.

Kete kritere te kerkuar ne dosjen e tenderit e kemi te plotesuar sepse kemi dorezuar listen e te punesuarve ku perfshihen i gjithe stafi i kompanise tone.

Ne jemi kompani e ndertimit dhe nuk kemi ndonje aktivitet tjeter biznesor andaj i tere stafi i prezentuar ne listen e te punesuarve eshte i angazhuar ne ekzekutimin dhe menaxhimin e projekteve ne fushen e ndertimit.

AK nuk duhet te tentoje te beje diskriminim sepse punetor nuk do te thote vetem punetor fizik mirepo punetor ka kuptimin e te punesuarit ne profile te ndryshme dhe ne si kompani ofertuese kemi dorezuar listen e punetoreve te lemive te ndryshme e cila permban 38 te punesuar e te cilet direkt jane te lidhur ne menaxhimin e projekteve ndertimore.

Stafi profesional I kompanise (inxhinieret) ne asnje kerkese te dosjes se tenderit nuk eshte kerkuar qe te mos perfshihen ne listen e te punesuarve , perkundrazi ne kerkesen e dosjes se tenderit ku eshte kerkuar lista prej 30 te punesuarve kerkohet qe edhe stafi profesional te jete I perfshire, kerkesa e dosjes eshte si me posht:

Dëshmia 5. Lista e stafit me kualifikime profesionale dhe pregatitje shkollore numri i punetorve 30 dhe te kete kontrata me punetor ose parakontrata. Puntorë të profileve të ndryshme.

Sa I perket kontratave te punetoreve ne mendojme qe ky vleresim i AK nuk qendron fare sepse eshte e vertete qe ne kemi ndrruar statusin e kompanise nga NP EuroBesi ne EuroBesi Shpk mirepo ne asnje rrethane ndryshimi I statusit te kompanise nuk nenkupton ndryshimin e pronareve te kompanise ose nuk nenkupton qe eshte kompani e re.

Pas ndryshimit te statusit te kompanise nga NP EuroBesi ne EuroBesi Shpk ne kemi qene te detyruar qe te bejme vertetimin e kontratave me vulen e EuroBesi SHPK , mirepo data e fillimit te punes ka mbete e njejte per te punesuarit.

Ne kemi bashkangjitur listat e te punesuarve te ATK-se te vitit 2014 dhe vitit 2020 ,te cilat lista konfirmojn emrat e te punesuarve te cekur me lart qe jane te punesuar ne kompanine tone si para ndryshimit te statusit te kompanise si pas ndryshimit te statusit te kompanise.

Ne vleresojme se ky vleresim eshte jo real nga ana e AK sepse nuk kemi te bejme me kompani tjeter ne kete rast por kemi te bejme vete me ndryshim te statusit te kompanise dhe jo me kompani te re.

Edhe ne kete pike ne jemi plotesisht te pergjegjshem.

Ne mendojme qe AK ka bere shkelje te LPP-se me rastin e vleresimit te ketije tenderi sepse arsyet e eleminimit te kompanise tone nuk qendrojne.

Kerkojme nga OSHP qe te pranoje ankesen tone dhe te ktheje kete lend ne **RIVLERESIM** sepse jemi kompani e pergjegjeshme ne kete procedure tenderuse dhe kerkojme nga ana e AK qe gjate rivleresimit te beje vleresim real dhe te respektoj LPP-ne.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës:

Demi qe shkaktohet eshte fitimi I humbur nga kjo kontrate e percaktuar me ligjet ne fuqi.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, dhe*
- *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*